

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Shabanaj 2005” shpk,**

Në Tiranë, sot më datë 14.03.2024, unë i poshtëshënuari;

Florian Shabanaj, i datëlindjes 07.06.1983, lindur ne Baldushk Tirane dhe banues në Rruga Mihal Grameno Ndertese me Nr pasurie 2/440, Hyrja 1 Ap 14, Zona kadastrale 8190, Njesia 2 Tirane, identifikuar me dokument identifikimi, kartë identiteti, me numër personal I30607033R, me cilësinë e “ortakut themelues” deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Shabanaj 2005” shpk.**

**Neni 1.  
Emri, Forma**

Shoqëria do të ketë emrin **“Shabanaj 2005” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

**Neni 2  
Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

**Neni 3  
Selia**


Shoqëria **“Shabanaj 2005” shpk** e ka seline në adresë: Rruga Mihal Grameno Ndertese me Nr pasurie 2/440, Hyrja 1 Ap 14, Zona kadastrale 8190, Njesia 2 Tirane dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

**Neni 4  
Objekti i veprimitarise**

Objekti i ushtrimit të veprimitarise për shoqërinë **“Shabanaj 2005” shpk** është: është kryerja e të gjitha punimeve te ndertimit me hekurin, armaturat dhe sherbimeve te tjera komplementare te ndertesave te reja dhe ato ne rikonstruksion.

**Neni 5  
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.



## **Neni 6 Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(nje) kuote te cilat zotërohet si më poshtë: Florian Shabanaj , i datëlindjes 07.06.1983, lindur ne Baldushk Tirane dhe banues në Rrugë Mihal Grameno, Ndertese me Nr pasurie 2/440, Hyrja 1 Ap 14,Zona kadastrale 8190,Njesia 2 Tirane,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti, me numër personal ,I3060703R, zoteron një kuotë ose 100 % të shoqerisë.Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqerisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqerisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

## **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqerisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.


Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqerisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **Neni 8 Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqerisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### **Neni 9 Administrimi**

Administrator i shoqërisë “**Shabanaj 2005**” shpk është: Florian Shabanaj , i datëlindjes 07.06.1983, lindur ne Baldushk Tirane dhe banues në Rruga Mihal Grameno Ndertese me Nr pasurie 2/440,Hyrja 1 Ap 14,Zona kadastrale 8190,Njesia 2 Tirane,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti, me numër personal ,I30607033R.

Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar.Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqerisë qe eshte data 14.03.2024.

Afati i emerimit te administratorit eshte deri me 14.03.2029.

#### **Neni 10 Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.

#### **Neni 11 Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.

Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare “**Shabanaj 2005**” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

#### **ORTAKET THEMELUES**

**Florian Shabanaj**

*Florian Shabanaj*

Tiranë, më datë 14.03.2024

